



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**PROJEKTLIGJI PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR STATUSIN E ANËTARËVE TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FORCËS SË SIGURISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS GJATË QËNDRIMIT TË TYRE TË PËRKOHSHËM NË TERRITORIN E
SHTETEVE RESPEKTIVE**

**DRAFT LAW ON RATIFICATION OF THE STATUS OF THE MEMBERS OF THE ARMED FORCES
OF THE REPUBLIC OF ALBANIA AND SECURITY FORCE OF REPUBLIC OF KOSOVO DURING
THEIR TEMPORARY RESIDENCE IN RESPECTIVE STATES TERRITORY**

**NACRT ZAKONA O RATIFIKACIJI SPORAZUMA O STATUSU PRIPADNIKA ORUŽANIH SNAGA
REPUBLIKE ALBANIJE I SNAGA BEZBEDNOSTI REPUBLIKE KOSOVO TOKOM NJIHOVOG
PRIVREMENOG BORAVKA NA TERITORIJI RESPEKTIVNIH DRŽAVA**

<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës, Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Miraton:</p> <p style="text-align: center;">LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR STATUSIN E ANËTARËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FORCËS SË SIGURISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS GJATË QËNDRIMIT TË TYRE TË PËRKOHSHËM NË TERRITORIN E SHTETEVE RESPEKTIVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>Ky ligj ka për qëllim Ratifikimin e Marrëveshjes për Statusin e Anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive.</p>	<p>The Assembly of the Republic of Kosovo, Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo, Approves:</p> <p style="text-align: center;">LAW ON RATIFICATION OF THE STATUS OF THE MEMBERS OF THE ARMED FORCES OF THE REPUBLIC OF ALBANIA AND SECURITY FORCE OF REPUBLIC OF KOSOVO DURING THEIR TEMPORARY RESIDENCE IN RESPECTIVE STATES TERRITORY</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Purpose</p> <p>This law has the purpose to Ratify the Agreement for Status of Members of the Armed Forces of the Republic of Albania and Security Forces of the Republic of Kosovo during their temporary stay on the territory of respective states.</p>	<p>Skupština Republike Kosova, Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosova, Usvaja:</p> <p style="text-align: center;">ZAKON O RATIFIKACIJI SPORAZUMA O STATUSU PRIPADNIKA ORUŽANIH SNAGA REPUBLIKE ALBANIJE I SNAGA BEZBEDNOSTI REPUBLIKE KOSOVO TOKOM NJIHOVOG PRIVREMENOG BORAVKA NA TERITORIJI RESPEKTIVNIH DRŽAVA</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Svrha</p> <p>Ovaj zakon ima za cilj da Ratifikuje Sporazum o Statusu pripadnika Oružanih Snaga Republike Albanije i snaga Bezbednosti Republike Kosovo tokom njihovog privremenog boravka na teritoriji respektivnih država.</p>
-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

<p style="text-align: center;">Neni 2 Fusha e zbatimit</p> <p>Marrëveshja për Statusin e Anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive është pjesë përbërëse e këtij ligji (Shtojca 1) dhe zbatohet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope</p> <p>The Agreement on Status of Members of the Armed Forces of the Republic of Albania and Security Forces of the Republic of Kosovo during their temporary stay on the territory of respective states is a constituent part of this law (Annex 1) and is applied between the Republic of Kosovo and the Republic of Albania.</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Polje sprovođenja</p> <p>Sporazum o Statusu Pripadnika Oružanih Snaga Republike Albanije i Snagama Bezbednosti Republike Kosovo tokom njihovog privremenog boravka na teritoriji respektivnih država je sastavni deo ovog zakona (Dodatak 1) a primenjuje se između Republike Kosova i Republike Albanije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Hyrja në fuqi</p> <p>Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Entry into Force</p> <p>This law shall enter into force fifteen (15) days after publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Stupanje na snagu</p> <p>Ovaj zakon stupa na snagu petnaest (15) dana nakon objavljivanja u Službenom Listu Republike Kosovo.</p>
<p style="text-align: center;">Jakup Krasniqi</p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;">Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës</p>	<p style="text-align: center;">Jakup Krasniqi</p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;">Chairman of Parliament of Kosovo</p>	<p style="text-align: center;">Jakup Krasniqi</p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;">Predsednik Skupštine Kosova</p>



MARRËVESHJE

NDËRMJET

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

REPUBLIKËS SË KOSOVËS

për

**Statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë
dhe të Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës
gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive**

Republika e Shqipërisë
dhe
Republika e Kosovës

Duke e konsideruar bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë si shumë të rëndësishëm për paqen dhe stabilitetin në rajon dhe më gjerë;

Me dëshirën për të vendosur rregulla për qëndrimet e përkohshme të anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës në territorin e shteteve respektive,

bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

1. **“Forcë”** nënkupton personelin që i përket Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.
2. **“Përbërës civil”** nënkupton personelin civil që shoqëron një Forcë
3. **“Person në varësi”** nënkupton bashkëshortin/en e një anëtari të një force apo të një përbërësi civil, ose fëmijën/et e një anëtari të tillë që është në varësi të tij apo të saj.
4. **“Shtet Pritës”** nënkupton Palën në territorin e së cilës është vendosur ose kalon transit forca ose përbërësi civil i Shtetit Dërgues.
5. **“Shtet Dërgues”** nënkupton Palën, të cilës i përket forca që dërgohet në territorin e Shtetit Pritës.

Neni 2
Qëllimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje rregullon procedurat e hyrjes, daljes, qëndrimit të përkohshëm dhe statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe anëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në territorin e shtetit përkatës, si edhe të përbërësve civilë apo personave në varësi.

Neni 3

Procedura dhe qëndrimi i përkohshëm

Procedurat për hyrjen, daljen dhe qëndrimin e përkohshëm të anëtarëve të Forcës, të përbërësve civil dhe të personave në varësi rregullohen me legjislacionin kombëtar të Shtetit Pritës. Qëndrimi i përkohshëm në territorin e Shtetit Pritës, sipas kësaj Marrëveshje, ka për qëllim stërvitjen, trajnimin, kalimin tranzit, kryerjen e operacioneve të ndihmës humanitare, operacionet e kërkim- shpëtimit si dhe aspekte të tjera të bashkëpunimit midis forcave. Detajet lidhur me qëllimin e qëndrimit, numrin e anëtarëve të forcës, përbërësve civile dhe personave në varësi, vendin e dislokimit, kohëzgjatjen dhe informacione të tjera të nevojshme përcaktohen ndërmjet autoriteteve kompetente. Nëse do të gjykohet e nevojshme mes palëve mund të lidhen marrëveshjet teknike përkatëse.

Neni 4

Hyrja dhe dalja nga territori

1. Anëtarët e Forcës së Shtetit Dërgues duhet të jenë të pajisur me këto dokumente, kur hyjnë ose dalin nga kufiri i Shtetit Pritës:
 - 1.1. Pasaporta ose Karta Ushtarake e Identitetit;
 - 1.2. Urdhri për lëvizje, kolektiv ose individual, i lëshuar në gjuhën shqipe si dhe në gjuhën angleze apo frënge, nga institucioni përkatës i Shtetit Dërgues.
2. Përbërësi civil dhe personat në varësi duhet të jenë të pajisur me pasaporta ose karta identiteti.
3. Shteti Pritës do të pranojë këto dokumente si dokumente të rregullta për hyrjen në pikat e kalimit kufitar nga anëtarët e Forcës së Shtetit Dërgues, pa ndonjë kërkesë shtesë, me përjashtim kur specifikohet në marrëveshjet teknike pasuese.
4. Personeli i Forcës së Shtetit Dërgues kur kalon kufirin për të hyrë/dalë nga territori i Shtetit Pritës, duhet të jetë i veshur me uniformë ushtarake dhe t'i nënshtrohen detyrimit për zbatimin e rregullave të kontrollit kufitar.

Neni 5

Armatimi

1. Autoritetet kompetente të Shtetit Dërgues informojnë autoritetet kompetente të Shtetit Pritës për numrin, tipin dhe sigurojnë çdo informacion tjetër të nevojshëm mbi armët luftarake dhe municionet që anëtarët e Forcës së Shtetit Dërgues do të kenë me vete gjatë qëndrimit të përkohshëm në Shtetit Pritës.
2. Personeli i Forcës së Shtetit Dërgues mund të mbajë armë në zbatim të urdhrave të lëshuara nga autoritetet përkatëse të Shtetit Dërgues, bazuar në legjislacionin e Shtetit Pritës dhe në legjislacionin ndërkombëtar për këto raste. Autoritetet e Shtetit Dërgues do t'i shqyrtojnë me përparësi kërkesat nga Shteti Pritës për sa i përket çështjes së armatimit dhe municioneve.

Neni 6
Siguria publike dhe Rendi kushtetues

Në rast se Shteti Pritës gjykon se siguria publike dhe rendi kushtetues i tij kërcënohet nga ana e një anëtari të Forcës të Shtetit Dërgues, Shtetit Pritës mund të kërkojë largimin e menjëhershëm të anëtarit/personit në fjalë nga territori i tij. Autoritetet e Shtetit Dërgues pajtohen me këtë kërkesë.

Neni 7
Respektimi i ligjeve dhe zakoneve

Anëtarët e Forcës së Shtetit Dërgues, përbërësit civil dhe personat në varësi, angazhohen të respektojnë ligjet, rregullat, zakonet dhe traditat e Shtetit Pritës dhe të mos përfshihen në asnjë veprimtari që del jashtë misionit të tyre në territorin e Shtetit Pritës.

Neni 8
Juridiksioni

1. Autoritetet e Shtetit Dërgues kanë të drejtë të ushtrojnë brenda territorit të Shtetit Pritës juridiksion disiplinor, civil dhe penal mbi anëtarët e Forcës së Shtetit Dërgues.
2. Autoritetet e Shtetit Pritës gëzojnë të drejtën për të ushtruar juridiksion ekskluziv mbi anëtarët e Forcës së Shtetit Dërgues, mbi përbërësit civilë dhe personat në varësi, në rastet e shkeljeve që janë të dënueshme nga legjislacioni i Shtetit Pritës dhe jo nga legjislacioni i Shtetit Dërgues, si edhe në rastet kur një nga subjektet e mësipërme kryen: shkelje që kanë të bëjnë me sigurinë, pavarësinë, rendin kushtetues dhe integritetin e Shtetit Pritës.
3. Autoritetet e Shtetit Pritës gëzojnë të drejtën parësore për të ushtruar juridiksion mbi anëtarët e Forcës së Shtetit Dërgues për veprën penale të vrasjes, plagosjes së rëndë, vepra të tjera penale kundër integritetit fizik dhe seksual, me përjashtim të rastit kur këto veprime janë drejtuar kundër një anëtari të Forcës së Shtetit Dërgues.
4. Autoritetet përkatëse të Shtetit Pritës dhe të Shtetit Dërgues do të bashkëpunojnë për zgjidhjen e të gjitha rasteve në të cilat ka të drejta që konkurrojnë me njëra – tjetrën për ushtrim të juridiksionit. Në qoftë se Shteti që ka të drejtën parësore vendos të mos ushtrojë juridiksion, ai duhet të njoftojë menjëherë autoritetet e Shtetit tjetër. Autoritetet e Shtetit që kanë të drejtën parësore të ushtrimit të juridiksionit do t'i përgjigjen me mirëkuptim kërkesës nga autoritetet e Shtetit tjetër për një përjashtim nga e drejta e tij në rastet kur Shteti tjetër mendon që një përjashtim i tillë është i një rëndësie të veçantë.
5. Nëse Shteti Pritës heq dorë nga e drejta për të ushtruar juridiksion penal ndaj një anëtari të Forcës së Shtetit Dërgues, përbërësi civil apo personi në varësi, Shteti Dërgues e largon menjëherë të dyshuarin nga territori i Shtetit Pritës.

6. Autoritetet e Shtetit Pritës dhe Shtetit Dërgues do të ndihmojnë dhe do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për ndalimin dhe arrestimin e anëtarëve të Forcave, përbërësit civil ose personave në varësi të tyre dhe dorëzimin e tyre tek autoritetet kompetente.

7. Autoritetet e Shtetit Pritës dhe Shtetit Dërgues do të ndihmojnë dhe do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në kryerjen e të gjitha hetimeve të nevojshme dhe në mbledhjen dhe përpunimin e provave.

Neni 9 **Kontrolli doganor**

1. Anëtarët e Forcës së Shtetit Dërgues, përbërësit civil, si dhe personat në varësi të tyre i nënshtrohen ligjeve dhe rregullave të vendosura nga autoritetet e doganave të Shtetit Pritës. Autoritetet doganore të Shtetit Pritës kanë të drejtën, sipas kushteve të përgjithshme të përcaktuara nga ligjet dhe rregullat e Shtetit Pritës të kontrollojnë anëtarët Forcës së Shtetit Dërgues, përbërësit civil dhe personat në varësi të tyre, të kontrollojnë bagazhet dhe automjetet e tyre si edhe të sekuestrojnë artikujt që ndalohen me ligj të futen në territorin e Shtetit Pritës.

2. Dokumentet zyrtare të pajisura me vulat zyrtare përkatëse nuk do t'i nënshtrohen kontrollit doganor.

Neni 10 **Përrjashtimi nga taksat dhe detyrimet doganore**

1. Forca e Shtetit Dërgues mund të importojë pa doganë pajisje për Forcën dhe sasi të arsyeshme ushqimesh, furnizimesh dhe mallra të tjera për përdorim ekskluziv të Forcës. Në rastet kur lejohet nga Shteti Pritës ky përjashtim përdoret edhe për përbërësit civilë të Forcës dhe personat në varësi.

2. Forca e Shtetit Dërgues importon dhe rieksporion pa pagesë doganore automjetet e shërbimit, të nevojshme për përmbushjen e misionit të tij në territorin e Shtetit Pritës. Automjetet e shërbimit të Forcës së Shtetit Dërgues përjashtohen nga çfarëdo takse kombëtare të Shtetit Pritës lidhur me përdorimin e tyre.

3. Anëtarët e Forcës, përbërësit civilë dhe personat në varësi të tyre mund të importojnë pa pagesë sendet dhe mobilet personale, si edhe automjetet për përdorim personal. Automjetet për përdorim personal nuk përjashtohen nga taksat kombëtare të Shtetit Pritës lidhur me përdorimin e tyre.

4. Atëherë kur nuk është i mundur përjashtimi i plotë nga taksat, detyrimet doganore, tarifat apo detyrime të tjera financiare të përcaktuara në legjislacionin e Shtetit Pritës, detyrimet nuk do të jenë në shkallë më të lartë se ato që zbatohen për personelin e Forcës së Shtetit Pritës.

Neni 11
Mbrojtja e Mjedisit

Shteti Dërgues njeh dhe pranon rëndësinë e mbrojtjes mjedisore në kontekstin e veprimtarive të realizuara nga anëtarët e Forcave të tij të Armatosura në Shtetin Pritës. Anëtarët e Forcave të Armatosura të Shtetit Dërgues pajtohen me dispozitat ligjore të Shtetit Pritës për mbrojtjen e mjedisit. Autoritetet kompetente të dy Shteteve bashkëpunojnë ngushtë së bashku për të gjitha çështjet e mbrojtjes mjedisore, veçanërisht për përgatitjen e stërvitjeve.

Neni 12
Leja e drejtimit të automjetit

Autoritetet përkatëse të Shtetit Pritës do të njohin në mënyrë të ndërsjellë, për qëllim qarkullimi në territoret e tyre, lejet e drejtimit/patentat e rregullta kombëtare të shoferëve, të lëshuara nga autoritetet kompetente përkatëse të Shtetit Dërgues, brenda afatit të tyre të vlefshmërisë, sipas kuadrit të tyre të brendshëm ligjor, për një anëtar të Forcës ose përbërës civil dhe personat në vartësi.

Neni 13
Shëndeti Publik

1. Shteti Dërgues respekton legjislacionin shëndetësor të Shtetit Pritës. Anëtarëve të Forcës së Shtetit Dërgues mund t'iu kërkohet të paraqesin një certifikate zyrtare shëndetësore të lëshuar nga autoritetet e Shtetit Dërgues, e cila konfirmon se këta persona nuk vuajnë nga sëmundje ngjitëse.

2. Autoritetet kompetente të forcës të Shtetit Pritës njoftojnë autoritetet kompetente të forcës të Shtetit Dërgues mbi këtë kërkesë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së planifikuar të hyrjes.

3. Në rastin kur konstatohet se një anëtar i Forcës së Shtetit Dërgues është i infektuar me një sëmundje ngjitëse dhe përbën rrezik për komunitetin, autoritetet përkatëse të Shtetit Pritës kërkojnë izolimin e përkohshëm ose largimin e menjëhershëm të personit nga territori i Shtetit Pritës.

Neni 14
Pretendimet mbi dëmet e shkaktuara

1. Pretendimet për dëmshpërblim në rast dëmsh të shkaktuara pasurisë së Shtetit Pritës nga anëtarët e Forcës së Shtetit Dërgues, gjatë ushtrimit të detyrës dhe jashtë saj, trajtohen sipas legjislacionit civil të Shtetit Pritës. Autoritetet kompetente të Palëve angazhohen të bashkëpunojnë ngushtë, duke ndihmuar njëra-tjetrën, për zgjidhjen e çështjes.

2. Pretendimet për dëmshpërblim nga palët e treta, në rast dëmshpërblimi të shkaktuara pasurisë së tyre nga anëtarët e Forcës së Shtetit Dërgues trajtohen nga autoritetet kompetente të Shtetit Pritës, të cilat kanë detyrën të informojnë menjëherë autoritetet kompetente të Shtetit Dërgues. Këto të fundit analizojnë rastin dhe dërgojnë pranë autoriteteve të Shtetit Pritës raportin e tyre.

3. Autoritetet kompetente të Shtetit Pritës vendosin nëse duhet paguar dëmshpërblimi dhe në çfarë shume është i justifikuar pretendimi i palës së dëmtuar, sipas ligjit të Shtetit Pritës. Dëmshpërblimi i paguhet palës së tretë të dëmtuar duke zbatuar raportin: 75% e shumës së dëmshpërblimit nga Shteti Dërgues dhe 25% nga Shteti Pritës.

4. Autoriteti i Shtetit Pritës paguan shumën e kompensimit në monedhën e tij vendase. Ai i kërkon autoritetit të Shtetit Dërgues të rimbursojë shumën e paguar. Autoriteti i Shtetit Dërgues rimburson shumën përkatëse brenda tre muajve.

Neni 15

Heqja dorë nga pretendimet

Palët tërheqin të gjitha pretendimet e tyre për plagosjen ose vdekjen e çdo anëtari të Forcës të ndodhur gjatë kryerjes së detyrave të tij zyrtare, me përjashtim të rasteve kur pasoja ka ardhur për shkak të veprimeve me dashje ose nga pakujdesia.

Neni 16

Shërbimet Mjekësore

Shteti Pritës ka për detyrë të sigurojë për personelin e Forcës së Shtetit Dërgues asistencë mjekësore dhe dentare në të njëjtat kushte si të personelit të Forcës së tij.

Neni 17

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim, me anë të konsultimeve dypalëshe dhe nuk do t'i referohet një pale të tretë për zgjidhje.

Neni 18

Zbatimi

1. Masat që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje realizohen ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, të cilat vënë në dijeni njëra-tjetrën mbi pikat e duhura të kontaktit për zbatimin e saj.

2. Palët mund të nënshkruajnë në të ardhmen, nëse e gjykojnë të nevojshme, Marrëveshje Teknike në përputhje dhe në zbatim të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 19
Plotësimi dhe ndryshimi

Kjo Marrëveshje mund të plotësohet dhe ndryshohet me shkrim, me pëlqimin e përbashkët të të dy Palëve.

Neni 20
Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pasi të dy Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën mbi përmbushjen e kërkesave ligjore shtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Data e hyrjes në fuqi mbetet data e marrjes së njoftimit të fundit.

Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi për një periudhë të papërcaktuar kohe. Marrëveshjes mund t'i jepet fund nga secila Palë me anë të një njoftimi me shkrim për këtë qëllim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Përfundimi i Marrëveshjes hyn në fuqi gjashtë (6) muaj pas marrjes së njoftimit.


E bërë në Prizren, më 1 Korrik 2013, në dy kopje origjinale, secila prej tyre në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, të gjitha tekstet njëlloj autentike. Në rast të paqartësive në interpretim apo zbatim të dispozitave të kësaj marrëveshjeje, versioni në gjuhën shqipe do të mbizotëroj.

Për Republikën e Kosovës
Agim Çeku



Ministër i FSK-së

Për Republikën e Shqipërisë
Arben Imami



Ministër i Mbrojtjes



AGREEMENT

BETWEEN

THE REPUBLIC OF ALBANIA

AND

THE REPUBLIC OF KOSOVO

on

**Status of the Members of Armed Forces of the Republic of Albania and the
Security Forces of the Republic of Kosovo
during their temporary stationing in the territories of respective states**

The Republic of Albania
and
The Republic of Kosovo

Considering of a high level of importance the cooperation in defence and security areas in the interest of regional peace and stability and beyond;

Desiring to establish appropriate common rules on the temporary stationing of the members of Armed Forces of the Republic of Albania and the Security Forces of the Republic of Kosovo in the territories of the respective states

have agreed as follows:

Article 1
Definitions

1. **"Force"** means the personnel belonging to the Armed Forces of the Republic of Albania and Security Forces of the Republic of Kosovo.
2. **"Civilian Component"** means the civilian personnel accompanying a Force.
3. **"Dependant Person"** means the spouse of a member of a force or a civilian component, or the child/children of such a member depending on him or her for support.
4. **"Host Country"** means the Party in the territory of which the force or civilian component of the Sending State is stationed or passing in transit.
5. **"Sending Country"** means the Party to which it belongs the force sent in the territory of the Host country.

Article 2
Purpose of Agreement

This Agreement regulates the procedures for entry, exit, temporary stationing, and status of the members of Armed Forces of the Republic of Albania and members of the Security Forces of the Republic of Kosovo in the territory of respective countries, as well as civilian components or dependant persons.

Article 3
Procedure and temporary stationing

Procedures for entry, exit, and temporary stationing of the members of the Force, of the civilian components and of dependant persons are regulated based upon the national legislation of the Host Country. Temporary stationing in the territory of the Host Country, based on this

Agreement, is focused on exercises, training, passing in transit, humanitarian aid operations, search and rescue operations, and other aspects of cooperation between the countries. The details concerning the aim of the stationing, the number of the members of the force, civilian components and dependant persons, the place of deployment, duration and other necessary information are defined between the competent authorities. If necessary, the parties may agree on a technical respective agreement.

Article 4 **Entry and Exit from the territory**

1. The members of the Force of Sending Country shall be required to have these documents, in cases of entry and exit from the borders of the host country:
 - 1.1. Passport or Military Identity Card
 - 1.2. Travel Order, collective or individual, issued in the Albanian language, and in English or French language, by the relevant institution of the Sending Country.
2. Civilian component and dependant persons shall be required to have passports or identity cards.
3. The Host Country shall accept these documents as regular documents for the entry in the border check points of the members of the Force of Sending Country, without any additional request, unless otherwise specified in the additional technical agreement.
4. The personnel of the force of Sending Country, when passing the border for entry or exit from the territory of the Host Country, shall wear military uniform and respect the obligations related to border control rules.

Article 5 **Weapons**

1. Competent authorities of the Sending Country shall provide related information to the Host Country about the number, type, and any other necessary information on military weapons and ammunition the members of the Force of the Sending Country will have with them during their temporary stationing period in the territory of the Host Country.
2. The personnel of the Force of Sending Country can carry weapons for the execution of the issued orders from the relevant authorities of the Sending Country, based on the legislation of the Host Country and domestic legislation in these cases. The authorities of the Sending Country shall elaborate with priority the requests from the Host Country regarding weapons and ammunition issues.

Article 6
Public Security and Constitutional Order

In cases when the Host Country deems that its public security and constitutional order is threatened by a member of the Force of the Sending Country, the Host Country may claim the immediate departure of the above mentioned member/ person from its territory. The authorities of the Sending Country shall comply with this request.

Article 7
Compliance with laws and customs

The members of the force of Sending Country, civilian components, and dependant persons, shall be engaged to comply with laws, rules, customs and traditions of the Host Country and shall not be involved in any activity which is out of their mission in the territory of the Host Country.

Article 8
Jurisdiction

1. The Authorities of the Sending Country have the right to exercise within the territory of the Host Country the disciplinary jurisdiction, civil and criminal one, for the members of the Force of Sending Country.
2. The Authorities of the Host Country enjoy the right to exercise exclusive jurisdiction over the members of the Force of Sending Country, on the civilian components and dependant persons, in cases of violations which are punishable by the legislation of the Host Country and not punishable by the legislation of the Sending Country, and in cases when one of the above subjects commits violation concerning the security, independence, constitutional order and integrity of the Host Country.
3. The Authorities of the Host Country enjoy the primary right to exercise jurisdiction over members of the Force of the Sending Country concerning the criminal offence of murder, serious injury, and other criminal offences against the physical and sexual integrity, with the exception of cases when these actions are directed against a member of the Force of the Sending Country.
4. The relevant Authorities of the Host Country and the Sending Country shall cooperate for the settlement of all cases in which there are competing rights with each other on the exercise of jurisdiction. If the Country which has the primary right decides not to exercise the jurisdiction, it shall inform immediately the authorities of the other Country. The Authorities of the Country which have the primary right of the exercise of jurisdiction shall respond with a common understanding to the request of authorities of the other Country for an exception from its right in cases when the other Country deems that such an exception is of specific importance.

5. If the Host Country waives the right to exercise criminal jurisdiction against a member of the Force of the Sending Country, a civilian component or a dependant person, the Sending Country shall expel immediately the suspected person from the territory of the Host Country.

6. The Authorities of the Host Country and the Sending Country shall assist and cooperate with each other for the detention and arrest of the members of the Force, of civilian persons or their dependant persons, and their surrender to the competent authorities.

7. The Authorities of the Host Country and Sending Country shall assist and cooperate with each other for the execution of all necessary investigations and collection of elaboration of evidence.

Article 9 Customs Control

1. The members of the Force of Sending Country, the civilian component and their dependant persons, shall comply with laws and rules established by the customs authorities of the Host Country. The Customs authorities of the Host Country enjoy the right, according to the general conditions defined by laws and rules of the Host Country, to control the members of the Force of the Sending Country, the civilian component and their dependant persons, to check their baggage and vehicles, as well as to seize the items prohibited by law to be introduced in the territory of the Host Country.

2. Official documents with their respective official seals shall not be subject to customs control.

Article 10 Exemption from taxes and customs obligations

1. The Force of the Sending Country can import, without any customs fees, equipment for the Force and other reasonable quantity of food, supply and other goods for the exclusive use of the Force. In cases when it is allowed by the Host Country, this exemption is also used for civilian components of the Force and dependant persons.

2. The Force of the Sending Country shall import and re-export, without any customs fees, the service vehicles required for the accomplishment of the mission in the territory of the Host Country. The service vehicles of the Force of the Sending Country are exempt from any national taxes of the Host Country concerning their use.

3. The members of the Force, civilian components and their dependant persons can import without any payment their personal items and furniture, and their personal vehicles. The vehicles for personal use are not subject to exempt from national taxes of the Host Country concerning their use.

4. When it is not possible a total exemption from taxes, customs obligations, tariffs or other financial obligations defined in the legislation of the Host Country, the fees shall not be higher than those imposed to the personnel of the Force of the Host Country.

Article 11
Environmental Protection

The Sending Country shall acknowledge and accept the importance of environmental protection in the context of activities carried out by the members of its armed Force in the territory of the Host Country. The members of the Armed Force of the Sending Country shall comply with legal provisions of the Host Country on environmental protection. The competent Authorities of both Countries shall closely cooperate on all issues of environmental protection, especially for the conduct of exercises.

Article 12
Vehicle Driving Licences

The relevant Authorities of the Host Country shall mutually acknowledge, for the purposes of circulation in their territories, the regular national driving licences of the drivers, issued by the competent authorities of the Sending Country, within their validity period, according to the internal legal framework, for the members of the Force or civilian component and their dependant persons.

Article 13
Public Health

1. The Sending Country shall comply with the health legislation of the Host Country. The members of the Force of Sending Country can be required to submit an official health certificate issued by the authorities of the Sending Country, confirming that these persons do not suffer from contagious diseases.
2. The competent authorities of the Force of the Host Country shall notify the relevant authorities of the Force of Sending Country upon such request, not later than fifteen (15) days before the planned date of the entry of the force in the territory of the Host Country.
3. In cases when it is observed that a member of the Force of the Sending Country is infected with a contagious disease and represents a risk to the community, the authorities of the Host Country shall claim the temporary isolation or immediate repatriation of the above person from the territory of the Host Country.

Article 14

Claims on caused damages

1. Claims for remunerations in cases of damages caused to properties of the Host Country by the members of the Force of the Sending Country, during the exercise of their mission and beyond, shall be settled in accordance with the civil legislation of the Host Country. The competent authorities of the Parties shall engage to closely cooperate by helping each other for the settlement of the issue.
2. Claims of remunerations from the third parties, in case of damages caused to their property by the members of the Force of the Sending Country, shall be settled by the competent authorities of the Host Country, which have the task to immediately inform the competent authority of the Sending Country. The latter shall provide an analysis of the specific case and submit their appropriate report to the authorities of the Host Country.
3. The competent authorities of the Host Country decide if the remuneration shall be paid and at what amount is the claim caused to the injured party justified, based on the law of the Host Country. The remuneration to the third injured party shall be based on the rates: 75% of the total remuneration is paid by the Sending Country and 25% by the Host Country.
4. The authority of the Host Country shall pay the total remuneration in local currency. It shall also ask the authority of the Sending Country for financial reimbursement at its expense. The authority of the Sending Country shall reimburse its related sum of money within three months.

Article 15

Withdrawal from claims

The Parties shall withdraw all their claims for the injury or death of any of the members of the Force occurred during the exercise of his official duties, with the exception of cases when the consequence arises from intentional actions or negligence.

Article 16

Medical Services

The Host Country shall be responsible to provide for the personnel of the Force of Sending Country medical and dental assistance at the same level of condition provided for the personnel of its Force.

Article 17

Settlement of Disputes

Any disputes arising from the implementation or interpretation of this Agreement shall be resolved based on common understanding, through bilateral consultations and shall not be referred to any other third party for solution.

Article 18
Implementation

1. Measures related to the implementation of this Agreement shall be carried out by the Ministry of Defence of the Republic of Albania and the Ministry for Security Forces of the Republic of Kosovo, which shall notify each other on their respective points of contacts for its implementation.

2. If necessary, the Parties can sign a Technical Agreement in the future, in accordance with and in support of the implementation of this Agreement.

Article 19
Amendments and changes

This Agreement can be amended and changed in a written form, with the consent of both Parties.

Article 20
Entry into Force, duration and termination


This Agreement shall enter into force after both Parties have notified each other on the accomplishment of the state legal requirements required for the entry into force. The date of the entry into force is the date of last notification by the parties.

This Agreement shall remain into force for an indefinite period of time. The Agreement can be terminated by each of the Parties by a written notice for this purpose via diplomatic channels. The termination of the Agreement shall become effective six (6) months after the receipt of notice.

Done in Prizren, on 1 July 2013, in two original copies, each in the Albanian, Serbian and English languages, all texts being equally authentic. In case of any dispute in the interpretation or implementation of the provisions of this Agreement, the Albanian version shall prevail.

For the Republic of Kosovo


Agim Çeku



Minister of KSF

For the Republic of Albania

Arben Imami



Minister of Defence



SPORAZUM

IZMEĐU

REPUBLIKE ALBANIJE

I

REPUBLIKE KOSOVO

**O statusu pripadnika Oruzanih Snaga Republike Albanije
i Snage Bezbednosti Republike Kosovo
za vreme njihovog privremenog boravka na teritoriju relevantnih država**

Republika Albanija
i
Republika Kosovo

Smatrajuci saradnju u oblasti odbrane kao veoma važno za mir i stabilnost u regionu i šire,

Sa željom da uspostave pravila za privremeni boravak pripadnika Oružanih Snaga Republike Albanije i pripadnika Snage Bezbednosti Republike Kosovo na teritoriju relevantnih država,

dogovorile se o sljedecem:

Član 1
Definicije

1. **"Snaga"** podrazumeva osoblje koje pripada Oružanim Snagama Republike Albanije i Snage Bezbednosti Republike Kosovo.
2. **"Civilni sastav"** podrazumeva civilno osoblje koje prati jednu snagu.
3. **"Zavisno lice"** podrazumeva suprugu/a pripadnika snage ili civilnog sastava, ili dete/cu istog pripadnika jedne snage koje zavisi od njega ili od nje.
4. **"Drzava Domaćin"** podrazumeva Stranu na cijoj teritoriji se nalazi, ili tranzitno prolazi snaga ili civilni sastav drzave koja to salje.
5. **"Drzava upućenik"** podrazumeve Stranu, kojoj pripada snaga koja se upućuje na teritoriju Drzave Domaćin.

Clan 2
Svrha sporazuma

Ovaj sporazum reguliše postupak ulaska, izlaska, privremenog boravka i status pripadnika Oružanih snaga Republike Albanije i pripadnika Snage Bezbednosti Kosova na respektivne teritorije država, isto i za civilne sastave ili zavisna lica.

Clan 3
Postupak i privremeni boravak

Postupci za ulazak, izlazak i privremeni boravak pripadnika Snaga, civilnih sastava i zavisnih lica regulišu se nacionalnim zakonodavstvom zemlje domaćina. Privremeni boravak na teritoriji države domaćina iz ovog Sporazuma ima za cilj vežbu, trening, tranzitan prelazak, izvođenje operacija humanitarne pomoći, oparacije traganja i spasavanja isto i drugim aspektima saradnje između snaga. Detalje povezane sa svrhom boravka, broj pripadnika snage, civilnih sastava i zavisnih lica, mesto dislociranja, vreme trajanja i razne druge neophodne informacije, definira se od nadležnih organa. Ako se smatra da je to neophodno, između stranaka mogu se sklopiti određene tehničke sporazume.

Clan 4**Ulazak i izlazak iz teritorije**

1. Pripadnici Snage Drzave Upućenik treba da poseduju sljedeće isprave prilikom ulaska ili izlaska na granicu Zemlje Domaćina :
 - 1.1. Pasoš i Vojna Lična Karta.
 - 1.2. Nalog za pokret,kolektivno ili individualno,to na albanski jezik isto i na engleskom ili francuskom jeziku, izdato od nadležnog organa Drzave Upućenik.
3. Civilni sastav i zavisna lica treba da poseduju pasoše ili lične karte.
4. Država Domaćin traba prihvatiti ove isprave kao validne dokumente za ulazak preko graničnih prelaza pripadnika Snaga Drzave Upućenik, bez dodatnih uslova, osim slučaja kad je to navedeno u sljedećim tehničkim sporazumima.
5. Osoblje Snage Drzave Upućenik, treba da su u vojnim uniformama i da podležu obavezi sprovođenja granične kontrole.

Clan 5**Oružje**

1. Nadležni organi Države Upućenik izvrši obavestjenju nadležnih organa Države Domaćin o broju, tip i obezbede svaku potrebnu informaciju o borbenim oružjama i municije koje pripadnici Sile Države Upućenik ce nositi sa sobom za vreme privremenog boravka u Državi Domaćin.
2. Osoblje Snage Države Upućenik može držiti oružje u skladu sa naredbama izdatim od strane organa Države Upućenik, na osnovu zakona Države Domaćin i međunarodnog zakonodavstva u ovim slucajevima. Vlasti Države Upućenik ce prioritetno razmotriti zahteve Države Domaćin na pitanje oružja i municije.

Clan 6**Javna bezbednost i javni poredak**

U slučaju da Država Domaćin smatra da javni bazbednost i ustavni poredak preti se od strane jednog pripadnika Snage Države Upućenik, Država Domaćin moze zahtevati hitno uklanjanje pripadnika/lica iz svoje teritorije. Vlasti Države Upućenik slaže se sa ovim zahtevom.

Clan 7**Poštovanje zakona i običaja**

Pripadnici Snage Države Upućenik,civilni sastavi i zavisna lica, obvezuju se da poštuju zakon, pravila, običaje i tradicije Države Domaćin i da se ne meša u neku delatnost koja spada van svoje misije na teritoriji Države Domaćin.

Clan 8 **Nadležnost**

1. Vlasti Države Upućenik poseduju pravo da na teritoriji Države Domaćin vrše svoju disciplinsku, civilnu i krivičnu nadležnost nad pripadnicima Snage Države Upućenik.
2. Vlasti Države Domaćin poseduju pravo da vrše isključivu nadležnost nad pripadnicima Snage Države Upućenika, civilnog sastava i zavisnih lica u slučajevima dela, kaznjiva po zakonu Države Domaćin a ne po zakonu Države Upućenik, isto i u slučajevima kad jedan od gore navedenih subjekata vrši kršenja u oblasti bezbednosti, nezavisnosti, ustavnog poretka i integriteta Države Domaćin.
3. Vlasti Države Domaćina, poseduju primarno pravo da vrše svoju nadležnost nad pripadnicima Snage Države Upućenik za krivična dela ubistva, teške telesne povrede, drugih krivičnih dela protiv fizičkog i seksualnog integriteta, osim slucaja kad takvi postupci su usmereni protiv pripadnika Snage Države Upućenik.
4. Nadležni organi Države Domaćin i Države Upućenik treba da sarađuju da reše sva pitanja u kojima ima prava koje konkurišu jedna drugu zbog vršenja nadležnosti. U slučaju da Država kojoj pripada primarno pravo ne odlučuje da vrši svoju nadležnost, treba da odmah obavesti organe druge Države. Državne vlasti kojima pripada primarno pravo da vrše nadležnost, treba odgovoriti sa razumevanjem na zahtev vlasti druge Države za odricanje od svog prava u slučaju kad druga Država smatra da je to odricanje od posebnog značaja.
5. Ako Država Domaćin odustaje od prava da vrši krivičnu nadležnost nad pripadnikom Snage Države Upućenik, civilnog sastava ili zavisnog lica, Država Upućenik uklanja odmah osumnjičenog sa teritorije Države Domaćin.
6. Vlasti Države Domaćin i Države Upućenik ce pomoći i međusobno sarađuju da zaustavljaju i izvrse hapsenje pripadnika Snage, civilnog sastava i njihovih zavisnih lica, isto i njihov predaj pred nadležnim organima.
7. Vlasti Države Domaćin i Države Upućenik ce pomoći i međusobno sarađivati u obavljanju svih potrebnih istraga kao i u prikupljanju i obradi dokaza.

Clan 9 **Carinska kontrola**

1. Pripadnici Snage Države Upućenik, civilnog sastava i zavisna od njih lica, podležu zakonima i propisima namećenih od strane carinskih uprava Države Domaćin. Carinske vlasti poseduju pravo, da na osnovu opštih uslova, utvrđenim zakonima i propisima Države Domaćin, da vrše kontrolu nad pripadnicima Snage Države Upućenik, civilnog sastava i zavisnih lica, da provere prtljag, njihova vozila i da zaplene te artikle koje zakonom su zabranjene da ulaze na teritoriju Države Domaćin.
2. Zvanična dokumenta opremljena određenim službenim pečatima ne podleže carinskoj kontroli.

Clan 10**Oslobađanje od poreza i carinskih obaveza**

1. Snaga Države Upućenik može da bez carine uvozi opremu za Snagu, isto i razumne količine hrane, potrošnog materiala i druge vrste robe isključivo za upotrebu Snage. Tamo gde je dozvoljeno od Države Domaćin, ovo se pravo koristi i za civilni sastav Snage kao i za zavisna lica.
2. Snaga Države Upućenik bez carinski izvrši uvoz i izvoz službenih vozila potrebna za ispunjenje svoje misije na teritoriji Države Domaćin. Službena vozila Snage Države Upućenik, oslobođeni su od svakog nacionalnog poreza Države Domaćin na njihovo korišćenje.
3. Pripadnici Snaga, civilni sastav i njihovih zavisnih lica, mogu uvesti besplatno lične stvari i nameštaj isto i vozila za ličnu upotrebu. Vozila za ličnu upotrebu nisu oslobođene od nacionalnih poreza Države Domaćin u vezi njihovog korišćenja.
4. Tamo gde nije moguće potpuno oslobađanje od poreza, carinskih dažbina, tarifa ili drugih carinskih obaveza predviđena zakonodavstvom Države Domaćin, obaveze neće biti veće od onih koje se primenjuju za osoblje Države Domaćin.

Clan 11**Zaštita životne sredine**

Država Upućenik prepoznaje i prihvata značaj zaštite životne sredine u kontekstu aktivnosti koje pripadnici Oružanih Snaga Države Domaćin sprovode. Pripadnici Oružanih Snaga Države Upućenik slaže se sa zakonskim odredbama Države Domaćin za zaštitu životne sredine. Nadležne vlasti u obe Države međusobno sarađuju za sva pitanja zaštite životne sredine, a posebno za pripremu vojnih vežbi.

Clan 12**Vozačka dozvola**

Nadležni organi Države Domaćin će za obostrani pokret na njihovim teritorijama priznati vozačke dozvole-patente, nacionalne isprave za vozače, izdate od strane nadležnih organa Države Upućenika, u roku njihove važnosti, po njihovog unutrašnjeg pravnog okvira, za pripadnike Snage, civilnog sastava ili za lica zavisnih od njih.

Clan 13**Zdravstvena zaštita**

1. Država Upućenik poštuje zdravstveno zakonodavstvo Države Domaćin. Pripadnicima Snage Države Upućenik se može zahtevati da podnesu zvanično zdravstveno uverenje izdato od strane organa Države Upućenik, što potvrđuje da ova lica ne boluju od zaraznih bolesti.
2. Nadležni organi Snage Države Domaćin, javljaju nadležnim organima Snage Države Upućenik, o ovom zahtevu najkasnije 15 (petnaest) dana ispred datuma planiranog za ulazak.

3. U slučaju da jedan pripadnik Snage Države Upućenik je zaražen od neke zarazne bolesti, a to predstavlja opasnost za zajednicu, određene vlasti Države Domaćin traže privremenu izolaciju ili hitno uklanjanje lica sa teritorije Države Domaćina

Clan 14

Potrazivanja i tvrdnja za nadoknadu štete

1. Potrazivanja za nadoknadu štete, u slučaju štete nanete državnoj imovini zemlje Domaćin od strane pripadnika Snage Države Upućenik, dok su na dužnosti ili van nje, tretira se civilnim zakonodavstvom Države Domaćin. Nadležne vlasti Strana angažuju se da blisko saraduju, pomagajući jedni-drugima za rešenje pitanja.

2. Potrazivanja za nadoknadu štete trećih lica, u slučaju štete nanete njihovoj imovini od strane pripadnika Snage Države Upućenika, tretiraju nadležne vlasti Države Domaćin, koje su obavezne da hitno obaveste nadležne organe Države Upućenik. Ovi poslednji analiziraju slučaj i upute svoj izveštaj vlastima Države Domaćin.

3. Nadležne vlasti Države Domaćin moraju odlučiti da li treba da se naknada plaća i u kojem iznosu je opravdana tvrdnja oštećene stranke, po zakonu Države Domaćin. Naknada se plaća oštećenom trećem licu po implementaciji proporcija: 75% iznosa naknade plaća Država Upućenikaa 25% Država Domaćin.

4. Vlast Države Domaćin plaća iznos nadoknade svojom nacionalnom valutom. Ona traži od vlasti Države Upućenik da nadoknadi plaćeni iznos. Vlast Države Upućenik nadoknadi relevantni iznos u toku od tri meseci.

Clan 15

Odrićanje od tvrdnje

Strane povuku sve svoje tvrdnje zbog povreda ili smrti bilo kog člana Snage u vršenju službene dužnosti, osim ako je to posledica namerne akcije ili iz nehata.

Clan 16

Medicinske usluge

Država Domaćin, je obavezna da obezbedi medicinsku i stomatološku pomoć za osoblje Snage Države Upućenik pod istim uslovima kao za osoblje svoje Snage.

Clan 17

Rešavanje sporova

Eventualne sporove koje mogu nastati u vezi sa tumačenjem ili primjenom ovog sporazuma rešavaće se sporazumno, putem bilateralnih konsultacija i neće biti položeno za rešenje nekom trećem licu.

Clan 18

Implementacija

1. Mere koje se odnose na implementaciju ovog sporazuma će se postići između Ministarstva

Odbrane Republike Albanije i Ministarstva za Snagu Bezbednosti Kosova koje će jedna-drugog obavestiti o odgovarajućim kontaktnim tačkama za implementaciju.

2. U buduće i ako procenu da to je neophodno te u skladu i svrhom ostvaranja ovog Sporazuma, Stranke mogu potpisati i ostale Tehničke Sporazume.

Clan 19 Amandman

Ovaj Sporazum može se dopuniti i izmeniti u pisanoj formi, uz obostranu saglasnost Stranaka.

Clan 20 Stupanje na snagu, trajanje i prestanak

Ovaj sporazum stupa u snagu nakon što su obe Strane obavestile jedna-drugu o ispunjenju zakonskih uslova za njegovo stupanje na snagu. Dan stupanja na snagu bit će datum primanja posljednjeg obaveštenja.

Ovaj Sporazum ostaje na snazi za neodređenu vremenski period. Sporazum može raskinuti svaka Strana putem objavljivanja svoje namere u pismenoj formi preko diplomatskih kanala. Raskid sporazuma stupa na snagu 6 (šest) meseci nakon primanja obaveštenja.

Sačinjene na Prizrenu, dana 1 Jula 2013, u dva originalna primerka, svaka na Albanskom, Srpskom i Engleskom jeziku, pri čemu su svi tekstovi podjednako verodostojni. U slučaju sporova u prevodu ili provođenju odredaba ovog sporazuma, verzija na Albanskom biće merodavna.

Za Republiku Kosovo
Agim Çeku


Ministar KSB-a

Za Republiku Albanije
Arben Imami


Ministar Odbrane